Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Misioni këshillues ndërkombëtar nga UNFPA & UNECE raporton të gjeturat për Regjistrimit të Popullsisë (ReKos 2024)

26 prill 2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Mision këshillues i ekspertëve ndërkombëtarë në takimin përmbyllës diskutuan për të gjeturat për Regjistrimin e Popullsisë (ReKos 2024).

Ekspertët ndërkombëtarë nga UNFPA dhe UNECE gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë realizuan takime me institucione vendore dhe ndërkombëtare, si dhe i bënë disa vizita në terren për ta vëzhguar për së afërmi Regjistrimin e Popullsisë në terren (takime me Regjistrues, Mbikëqyrës, kryetarë komunash dhe shfrytëzues).

Takimi përmbyllës ishte organizuar nga UNKT, ku Misioni këshillues ndërkombëtarë shpalosi të gjeturat dhe rekomandimet preliminare. Në takim morën pjesë shumë organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të misioneve diplomatike të akredituara në Kosovë.